

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME MASSIMO D'ALEMA

Romë | Data: 16 janar, 2019

Kohëzgjatja: 68 minuta

Të pranishëm:

1. Massimo D'Alema (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja/Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Massimo D'Alema: Më bëj pyetje dhe unë do të përgjigjem.

Anna Di Lellio: Faleminderit president për këtë intervistë. Jemi këtu me Massimo D'Alema, që në vitin 1998, saktësisht me 21 tetor, ishte ish-komunisti i parë që u bë kryeministër i Italisë ose kështu lexojmë në një libër, një libër intervistë të mirë, që u publikua në korrik, po besoj, në verën e vitit 1999, menjëherë pas luftës. Çfarë do të thotë kjo? Pse është e rëndësishme të dihet që ju jeni ish-komunisti i parë që bëhet kryeministër? Ka diçka... sse është e çuditshme që një kryeministër ish-komunist ose një komunist bën luftë? Po flasim për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë.

Massimo D'Alema: Është sigurisht çudi sepse të gjitha politikat e mia, krejt historia ime ka qenë... Kur kam qenë fëmijë kam qenë antarë i Partizanëve për Paqe, kështu që të bëj luftë sigurisht ka qenë... Kurrë nuk kam pritur të bëhem kryeministër ose në veçanti të jem kryeministër dhe të gjindem për herë të parë pas luftës [së dytë botërore] në vendin tonë. Janë dy hera të para: e para është që një ish-udhëheqës i Partisë Komuniste Italiane, jo një ish-komunist në përgjithësi, një person që ishte anëtar i sekretariatit kombëtar të Partisë Komuniste, u bë kreu i qeverisë italiane dhe ishte hera e parë që Italia ishte e përfshirë në një konflikt që nga lufta. Më pas nuk ka pasur asgjë të tillë, mbetet rast i veçantë.

Ishte pa dyshim një situatë e paparashikueshme dhe ndër te tjera jo e lehtë, sepse brenda shumicës qeveritare ishte prezenca e së majtës, por gjithashtu e botës krishterë, sepse rezistenca kryesore kulturore ndaj përdorimit të forcës ishte gjithashtu nga bota krishterë. Nuk ishte një situatë e lehtë për tu menaxhuar në vend, ishte një vendim i vështirë, i dhimbshëm, i përjetuar me ankth të madh politik dhe njerëzor nga protagonistët. Në atë kohë zëvendës kryeministri ishte presidenti i tanishëm i republikës [Italiane] Sergio Mattarella. Ai nuk ishte pengesë, kishte mirëkuptim për nevojën e asaj çfarë po bënim, por sigurisht ai e ka përjetuar këtë situatë me ankth të madh.

Anna Di Lellio: Disa gjëra të rëndësishme në fjalimin tënd drejtuar parlamentit me 26 mars, 1999. Ke thënë, "Kjo ndërhyrje në Kosovë është e drejtë, legjitime dhe e duhur". Po e citoj nga teksti. A mund të i shpjegosh këto tri fjalë: e drejtë, legjitime dhe e duhur.

Massimo D'Alema: Ishte e drejtë sepse çfarë na shtyri... politikisht ishte e drejtë, kam provuar ta shpjegoj të vërtetën: ne nuk po shkonim në luftë, konflikti ishte i hapur, nëse dëshirojmë të shikojmë përtej Kosovës; ishte një luftë civile ballkanike që ndoqi shpërberjen e ish-Jugosllavisë, që u shoqërua nga një sërë luftërash civile që nxitën tre mijë të vdekur. Ne nuk po shkonim në luftë, në një mënyrë

ndërhyrja e NATO-s ishte e drejtë sepse u dha fund atyre luftëve, edhe pse rezultati ishte një ekuilibër delikat. Ishte një veprim ushtarak që i dha fund luftës, nuk shpalli luftë, lufta ishte aty, kishte të vdekur, ne ndërhyëm në një konflikt që ishte aty, ishte politikisht e drejtë.

Ishte legjitime. Kjo ishte pika më e vuajtur, kishte një denoncim për shkelje të Kushtetutës nga një grup juristësh, ishte arkivuar nga *Procura della Repubblica di Roma* [Prokuroria e Republikës së Romës], ishte një denoncim kriminal ndaj kryeministrit. Tema është shumë kundërshtuese, dhe ka mbetur kundërshtuese në kuptimin e legjitimitetit të një ndërhyrje ushtarake të motivuar prej arsyeve humanitare, mbrojtjen humanitare të popullatës. Kam menduar atëherë dhe vazhdoj të mendoj tani që është legjitim edhe pse veprimi i NATO-s nuk kishte gjetur autorizimin e Këshillit të Sigurimit të Kombëve të Bashkuara, rrënjësisht për shkak të vetos ruse, megjithatë BE-ja si e tillë kishte pranuar, le të themi, arsyet për veprimin ushtarak të NATO-s dhe ka shprehur mbështetjen për këtë veprim ushtarak, mbështetjen e saj politike. Dhe NATO, Bashkimi Evropian... këto ishin zgjedhje strategjike.

Italia, sipas nenit 11 të kushtetutës, heq dorë, le të themi, nga sovraniteti në momentin në të cilin merr pjesë në zgjedhjet që operohen kolektivisht nga aleancat dhe institucionet ndërkombëtare të të cilave jemi anëtarë. Sipas Kushtetutës, Kushtetuta jonë parashikon mundësinë, domosdoshmërinë për Italinë dhe kështu ligjshmërinë e asaj çfarë bëjmë, për të bërë zgjedhje brenda aleancave apo institucioneve ndërkombëtare. Pra, nga kjo pikëpamje teza e legjitimitetit u konfirmua përfundimisht nga vendimet e gjyqtarëve. Kishte një themel kushtetues sepse është e vërtetë që neni 11 kërkon dorëheqjen nga lufta, por gjithashtu është e vërtetë që Italia heq dorë nga sovraniteti kombëtar kur duhet të veproj apo të bëjë zgjedhje të përbashkëta me aleancat në të cilat është anëtarë.

Ishte e duhur sepse ne nuk mund të rrinim përderisa ajo ishte duke ndodhur, një operacion i shtypjes, një spastrim etnik, pasojat e të cilit ishin dhjetra ose qindra mijë refugjatë, masakra, një komb i civilizuar nuk mund të mos reagojë kundër kësaj, sipas mendimit tim, çfarë po ndodhte në kufijtë tanë. Pra, ndër të tjera kishte edhe një mbështetje të madhe të opinionit publik. Pastaj konflikti zgjati e të tjera, e të tjera, dhe kishte momente hutimi por vendimi për të marrë pjesë në veprimin e NATO-s kishte një mbështetje të madhe në Itali dhe kjo ishte e rëndësishme në atë moment. Gjithashtu kishim përkrahje politike, të gjitha forcat politike, me shumë pak përjashtime, ishin në përkrahje.

Anna Di Lellio: Por nuk kishte mbështetje nga e majta, e majta nuk e mbështeti ndërhyrjen.

Massimo D'Alema: E majta por gjithashtu Lega, Lega solidarizohej me Serbinë, le të themi (snickers).

Anna Di Lellio: Pse?

Massimo D'Alema: Në të majtën.... Megjithatë, mospajtimi nga e majta ishte jashtëzakonisht i përmbajtur, madje edhe brenda qeverisë kishte mospajtim. Kam thënë, në një moment, "Ka luftë, nuk mund ta diskutojmë, e marr përgjegjësinë time dhe nëse përfundon keq jap dorëheqje". Dhe në një pikë të caktuar kishte një lloj.... Ata që nuk u pajtonin, pranuan ta shfaqin mospajtimin e tyre në një mënyrë jashtëzakonisht të përmbajtur. Nuk kishim shfaqje të zhurmshme të mospajtit, nuk kishim tubime pacifiste, asgjë të tillë, kishim vështirësi, debate parlamentare të vështira, por mospajtimi ishte shumë i përmbajtur. Duhet ta pranoj, ata që nuk u pajtuan dhe vujatën, pranuan të vuajnë në heshtje.

Anna Di Lellio: Ti kishe një të kaluar komuniste, prandaj sigurisht e ke njohur Jugosllavinë, si u ndjeve? Ishte shpërbërja e Jugosllavisë, si e keni parë ju këtë situatë, duke e njohur vendin mirë?

Massimo D'Alema: Shpërbërja nacionaliste e Jugosllavisë, shfaqja e konflikteve detare, ishte shqetësuese. Në njërën anë mendohej për mrekullinë që bëri Tito kur ndërtoi këtë mozaik. Ishte mrekulli, ai i bëri këta njerëz të jetojnë bashkë për disa dekada. Dhe në anën tjetër kuptohej sa sipërfaqësor ky lloj bashkimi ishte. Nuk i kishte hequr arsytet më të thella për konflikt në një nga rajonet më të torturuar në botë, me përzierjen e tri feve, katolike, protestante, muslimane, një pikë kufitare në mës të perandorive, Astro-Hungarisë dhe Osmanëve, të cilat jo vetëm që kishin kontrast në pushtet dhe politikë, por gjithashtu ideologjikisht, përfaqësonin botë të ndryshme. Ballkani është një përqendrim i kontraditave të mëdha dhe fakti që këto rishfaqen nga thellësia e historisë, sikur historia të mos kishte kaluar, shekujt nuk kishin kaluar, ishte mbresëlënëse

Njëri kupton *longue durée*-në e Braudel: fantazmat u rishfaqën sikur të ishin mbjatur në dollap nga fillimi i viteve '900 deri në shpërbërjen e Jugosllavisë. Unë besoj që kjo situatë dramatike u menaxhua gabimisht, kryesisht nga Evropa, sepse... njëherë Gorbachev - në një moment isha anëtarë i fondacionit Gorbachev, kam marrë pjesë në konferenca, debate - thashë diçka të zgjuar, "Po, procesi i artikullimit kombëtar të ish-Jugosllavisë ishte i pashmangshëm, por Evropa bëri një gabim të madh, ata duhej të thërrisnin një konferencë të madhe ndërkombëtare dhe së pari të pajtoheshin dhe të ofrojnë garanci. Para se Evropa të nxitohet të njoh shtetet që dilnin nga shpërbërja e Jugosllavisë, është dashur t'i detyronim ata që të njohin njëri-tjetrin".

Kjo nuk është bërë, përkundrazi në disa mënyra Evropa udhëhoqi kontraste në Ballkan përgjatë vijave tradicionale të ndarjes: Gjermania menjëherë morri anën e Kroacisë, gjithashtu për shkak të, le të themi, një aleance fetare, kroatët u paraqitën menjëherë si murë mbrojtës i Perëndimit të Krishterë kundër barbarizmit; francezët kurrë nuk e fshehin simpatinë e tyre për serbët, me pak fjalë, një dialektikë u hapë përsëri... anglezët i inkurajuan luftëtarët islamikë që të vijnë në Ballkan... Po, po, pse jo? Gjithashtu kishim prani të islamizmit radikal, për një kohë u inkurajua, edhe tani e kemi këtë prezencë të islamizmit radikal, kryesisht në Bosnje, është mjaft shqetësuese. Pra, në një pikë Fuqitë Evropiane filluan të luajnë në Ballkan siç ne ishim në fillimet e viteve '900 në vend se te mendoheshin se si ta menaxhojnë shpërbërjen [e Jugosllavisë], lindjen e shteteve kombëtare, që ishte legjitime dhe ndoshta e pashmangshme.

Ne duhej të menaxhonim [këtë situatë] në mënyrën sa më pak konfliktuale. Në vend të kësaj çdo gjë ndodhi përmes luftërave, dhe natyrisht këto luftëra kishin shumë fajtorë, sigurisht fajtori kryesor ishte nacionalizmi serb, i cili kultivoi iluzionin për të mbajtur bashkë me dhunë atë që nuk ishte e mundur të bëhet bashkë më. Në fund, në eksperiencën e Jugosllavisë nuk kishte vetëm forcë, ishte edhe aftësia e Titos për të ndërtuar një ekuilibër. Ai ishte vetë kroat në Beograd, si shenjë e ekuilibrit... ishte sistemi i rotacionit [i presidencës të Jugosllavisë], shkurt, kishte një ekuilibër, një kompromis. Ideja e zëvendësimit të atij lloj të kompromisit me forcë nga serbët ishte një dështim, kryesisht për Serbinë dhe këtu është përgjegjësia historike e Milošević, por në anën tjetër edhe miopinë e Evropës që nuk garantonte një menaxhim sa më paqësorë, sa më konsensual, të procesit të lindjes së kombeve të ndryshme.

Anna Di Lellio: A e ke njohur Jugosllavinë? A e kishit vizituar Jugosllavinë?

Massimo D'Alema: Ne kishim një marrëdhënie me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, kur isha sekretar i Partisë Komuniste në Pulia, e kishim një “binjakëzim” [partneritet] me Lidhjen e Komunistëve të Malit të Zi, kam shkuar shpesh ne Titograd, siç quhej atëherë, në Bar, Cetinje, e kam njohur Jugosllavinë.

Anna Di Lellio: Si të është dukur ty si shtet?

Massimo D'Alema: Jugosllavia atëherë... duke e krahasuar me vendet e tjera të Bllokut Socialist ishte një vend i hapur, me krejt prapambetjen, ishte më i hapur, kishte më shumë mundësi për dialog, i shkurtër, duke mos e krahasuar me Mbretërinë e Bashkuar por me BRSS dhe Bullgarinë...

Anna Di Lellio: Dhe Kosova? Çfarë ke ditur për Kosovën?

Massimo D'Alema: Kam ditur shumë pak për Kosovën, Kosova nuk ishte njëra ndër pjesët që unë i njihja, e kam njohur Malin e Zi, Slloveninë në një mënyrë, por jo Kosovën, nuk kam pasur njohuri direkte për Kosovën.

Anna Di Lellio: Jemi duke e bërë këtë intervistë me 16 janar, në 20 vjetorin e këtij incidenti, masakrës në Reçak, që kishte një rol të rëndësishëm në ndërhyrjen e NATO-s.

Massimo D'Alema: Po.

Anna Di Lellio: A mund të na tregosh reagimin tënd kur keni marrë lajmin?

Massimo D'Alema: Imazhet, pjesëmarrja në zemërim për atë çfarë kishte ndodhur... ndër të tjera pas disa ditëve fotografi të kësaj masakre të 45 njerëzve bënë xhiron nëpër botë, e pata mundësinë t'a takoj Milutinović, në atë kohë president i Serbisë, përderisa Milošević ishte president i Federatës, le të themi, në mënyrë krejtësisht private. Me Milutinović kishim të njejtin dentist, një dentist i rëndësishëm në Romë që është me prejardhje nga Istria, ka studiuar në Jugosllavi, që gjithashtu e kam shok, e ka organizuar këtë takim dhe e kemi pasur një diskutim shumë të gjallë politik te dentisti. Milutinović ka menduar që NATO nuk do të ndërhynte, e kishte bërë këtë analizë, nuk e di se sa përfaqësonte mendimin e institucionit, ai tha, “Po, këto janë kërcënimet e perëndimit, por kurrë nuk do të keni guximin”. Kishte shumë arrogancë, shumë vetëbesim. Une thashë, “Po e nënvlerëson ndikim e këtyre fotografive në opinion publik dhe kjo do e shtyjë qeverinë të bëjë diçka, e ke gabim, duhet ta gjeni një zgjidhje politike, duhet të tërhiqni ushtrinë, ndaloni paraushtarakët”, sepse gjërat më të tmerrshme u bënë nga paraushtarakët. Ai tha, “Po, ajo ishte gabim, dhe kryesisht [gabimi ishte] që u fotografuan”.

Ishte një shprehje e cinizmit dhe e moskuptimit të asaj çfarë po ndodhte sepse amerikanët po shtynin, Clintoni ishte shumë i rëndësishëm, por sidoqoftë në Evropë po e kuptonim që nuk mund të rrinim pa bërë asgjë. Reçaku ishte shumë i rëndësishëm, kjo ishte një moment konfrontimi për udhëheqësit evropian gjithashtu edhe për ndikim që kishte në opinionin publik.

Anna Di Lellio: Folët për rolin e Evropës dhe SHBA, por SHBA-ja nxiti ndërhyrjen...

Massimo D'Alema: SHBA-ja ka nxitur shumë, sidomos Olbright dhe Clinton, sigurisht kishte një rol të rëndësishëm, dhe pastaj në menaxhimin e konfliktit dhe pas konfliktit Clintoni kishte një rol pozitiv.

Anna Di Lellio: Me kë nga udhëheqësit e tjetër kë biseduar [gjatë ndërhyrjes]?

Massimo D'Alema: Kam qenë në kontakt të përhershëm... kur është vendosur, ne si qeveri, unë, ne ishim më hezitues, unë kam insistuar më shumë se çdokush tjetër për të gjetur një zgjidhje politike, madje duke e përfshirë edhe Rusinë, nuk do ta fshehë që ne punuam deri në fund për të shmangur një veprim ushtarak, dhe kur duket qartë që do ta bëjmë atë unë fola me Clinton. Clinton tha, “Duhet të veprojmë, por ne e kuptojmë sa delikate është situata, që Italia është në të: këta janë kufijtë e juaj, këta janë fqinjët tuaj, kemi nevojë për mbështetjen e juaj politike dhe përdorimin e bazave të juaja”, Italia ishte baza kryesore, “nuk është e domosdoshme për Italinë të marrë pjesë”.

Isha unë ai që tha, me gjithë ankthin tim, hutimin dhe problemet politike, “Nëse duhet ta bëjmë këtë dua të marrë pjesë në vendimet politike, nuk po e hedhim...” Dhe nëse e shikon, ne kishim një rol shumë të ngjashëm me Francën dhe Anglinë dhe më të madh se Gjermania. Ne ishim plotësisht të përfshirë, dhe amerikanët e vlerësuan këtë, ishte një arsye e rëndësishme për vlerësim nga ana e amerikanëve, por e them prapë, ishte vendimi ynë. Ne mund të kishim pasur një përfshirje më të vogël, por pse?

Pjesa e Dytë

Massimo D'Alema: Shqetësimi im ishte të shmangim që Italia të jetë në pozicion të dytë, doja të merrja pjesë drejtpërdrejt sepse isha i interesuar për “më pas”, çfarë do të nodhte më vonë, pasojat. Tjetri shqetësim që e kam pasur nga fillimi ishte qartë që gjendja në Kosovë dhe konflikti do të kishte si efekt të parë një valë refugjatësh dhe nuk doja të kishim *boat people* [njerëz në barka] në Adriatik sepse do të duheshin të vinin te ne, ku do të shkonin? Te ne. Nuk është se refugjatët që kishin shkuar nga Kosova në Shqipëri do të kishin destinacione tjera të mundshme, pra kishte një pasojë të tërë që duhej të menaxhohej duke qenë brenda stafit të përgjithshëm të operacioneve ushtarake. Nga përvoja ime në politikë ndërkombëtare e dija se kur ka një operacion ushtarak ata që vënë çizmet në terren janë më të rëndësishëm se ata që qëndrojnë në shtëpi.

Jo, jo. Prandaj, ka pasur konsultim të përhershëm, veçanërisht me Clinton, të themi, deri te shkëmbimi i numrave, themi, e më vonë edhe me politikanë tjetër, dhe më një fazë të caktuar edhe me Schroeder dhe Chirac, sepse në një pikë ka pasur një mospajtim me anglezët se si të vazhdohet. Dhe gjithashtu, kur gjërat u zhvilluan në kuptimin e veprimit ushtarak, gjithashtu kur Gjenerali Clark përmes ushtrisë ose drejtpërdrejt me të. Jo, jo. Ka pasur një një sistem të konsultimit të përhershëm sipas nevojës dhe në një pikë ka pasur një takim, një takim mjaft të vështirë, ku morrën aksionet e konfliktit, ishte në Washington DC, ishte buzë 50 vjetorit të NATO-s. Sepse gjatë asaj kohe ishin festimet e 50 vjetorit të NATO-s, ishte miratimi i një pakti të ri strategjik të NATO-s dhe kishte një takim se si të vazhdohet. Dhe kjo ka ndodhur përafërsisht në ditën e 60-të të bombardimeve.

Pra, Italia ishte në terren nga pikëpamja ushtarake, me një diskutim, ishte diskutim i ashpër në fillim dhe në një moment të caktuar duhej menduar si të vazhdohet, në dy aspekte. I pari ishte bombardimi i Serbisë dhe ne ishim kundër kësaj, gjermanët gjithashtu ishin kundër kësaj, dhe në një moment

amerikanët dhe anglezët thanë, “Mirë, ne do të veprojmë pa strukturën e NATO-s, pa përdorur asetet e NATO-s”, dhe prandaj këto operime ushtarake u kryen me asete që nuk ishin të NATO-s, pra, me aeroplanët bombardues që u nisën nga Pennsylvania ose me raketa që u lëshuan nga barkat e anglezeve, jo nga asetet e NATO-s, nuk u nisën nga bazat italiane sepse ne nuk pajtoheshim me këtë.

Clark ka shkruar për këtë. Në një moment ishte një diskutim edhe më sfidues sepse idea u shtrua nga konflikti tokësor, shkurt, një pushtim tokësor me dhunë, dhe ne e diskutuam këtë mundësi, që u mbështet nga Blair dhe Aznar, dhe u refuzua me mjaft forcë. Para së gjithash, ushtria e NATO-s e bëri të qartë se ata kishin ndërmend të i dërgonin ushtarët e tyre në malet e Kosovës, sepse një operacion ushtarak tokësor nënkuptonte pushtimin e Serbisë, sepse vetëm kjo do të i jepte fund konfliktit, jo një luftë partizane me serbët në malet e Kosovës, që u konsiderua si një opsion i padëshirueshëm. Ishte një plan tjetër, dhe sipas mendimit tim, njerëz më të mençur, ndër të cilët e vë edhe vetën, thamë, “Jeni të çmendur, çfarë të bëjmë kur e okupojmë Beogradin, ju lutem?” Nuk ishte as këtu as atje.

Ishte një diskutim mjaft i pakandshëm dhe duhet të them se në fund Clinton konkludoi mençur, pa i prekur vlerat e diskutimit, tha, “Ne do të bëjmë vetëm çfarë mund të bëjmë së bashku, presidenti i SHBA-ve nuk mund të jetë ai që ndanë Evropën”. Më është kujtuar kjo në kohën e konfliktit në Irak. Clintoni ishte në një nivel tjetër, ai kishte një vizion tjetër, prandaj e mbylli këtë debat, duke e lënë me një anë këtë hipotezë, e cila u hodh poshtë. Pra, ne vazhduam, kishte diskutim të vazhdueshëm dhe në disa momente gjithashtu ishte diskutim mjaft problematik se si duhet të vazhdohet nga pikëpamja e ushtrisë dhe kishte gjithashtu shumë diskutime politike.

Një aspekt tjetër ishte marrëdhënja me islamizmin. Në një moment jemi shqetësuar për fluksin e luftëtarëve islamik, që nuk dua të them Shërbimi i Intelgjencës Angleze ndihmoi, por nuk u dallua dhe kjo ishte temë për një diskutim të nxehur dhe pastaj ishte një diskutim për sjelljen politike të konfliktit, sepse konflikti kishte një qëllim të kufizuar, që nuk ishte pavarësia e Kosovës, por ishte të detyrojmë Beogradin të tërheqë ushtrinë dhe grupet e paraushtarakëve nga Kosova dhe mbrojtja e popullatës dhe të detyrojmë.... Sidoqoftë, krejt kjo e kishte si qëllim zgjidhjen politike, ne u deshëm t'a thyenim Beogradin përmes presionit ushtarak, veprimi, për t'a pranuar këtë kusht.

Natyrisht na thamë, shumë mirë, por këtu duhet të bëhemi merak për dy gjëra: përderisa operacioni ushtarak vazhdon, si të zhvillojmë presion politik, dhe gjithashtu të mendojmë se çfarë vjen pastaj, zgjidhja. Pra, kemi punuar në dy drejtime, bashkë me amerikanët, Clintoni shikonte përpara me këtë: së pari të përfshinë Rusinë në një veprim... le të themi, në një moment veprimi u kry në emër tonin nga Ahtisari, ai u ngarkua, Ahtisari, ish-presidenti i Finlandës, me udhëheqjen e veprimeve politike dhe në anën tjetër të përfshihet Rusia, gjithashtu sepse ne duhet të përgaditemi për mundësinë dhe konflikti mund të gjente një zgjidhje nga Këshilli i Sigurisë të Kombeve të Bashkuara. Pra, qeveria ruse e ngarkoi Chernomyrdin, ish-kryeministrin e Rusisë, për të krijuar kontakte. Dhe Chernomyrdin e bëri atë me pajtimin tonë. Ai vinte në Romë, ka ndodhur disa herë, u takuam te Palazzo Chigi, kemi darkuar së bashku, thërrëm Clintonin dhe shërbimet tona sekrete e dërguan me aeroplanat e tyre në anën tjetër të Adriatikut to takohet me Milošević ose këdo që e përfaqësonte atë, dhe kjo ishte e rëndësishme, sepse i krijoi kushtet për, le të themi, zgjidhjen që e gjetëm më vonë.

Operacioni tjetër që bëme ishte të sigurojmë nga Milošević lirin e Rugovës. Sepse kemi menduar, me të drejtë, që Rugova mund të jetë, për historinë e tij, ai që mund të përfaqësonte, pas luftës, një perspektivë paqësore. Nuk kam pasur shumë simpati për UÇK-në si... dhe pra ideja për të gjetur një

personalitet i cili ishte shumë i angazhuar për të drejtat e kosovarëve... Menjëherë pas luftës kishte zgjedhje dhe Rugova... ishte referendum [për të], pra ai ishte personalitet që kishte lidhje të forta, një histori me vështirësi, por gjithashtu pacifist, jo fundamentalist, madje ishte katolik, në një konflikt që pa muslimanët dhe protestantët, ëhm, jo, ortodoks, ai ishte jashtë aspekteve ideologjike dhe fetare të konfliktit, ai ishte një intelektual me prapavijë në kulturën franceze.

Pra, filluam një bisedim të vështirë me Milošević. Ndër të tjera Italia ishte vendi i vetëm që mbajti Ambasadën e saj në Beograd, ishte një pozitë mjaft delikate. Duhet të them që gjithmonë e kemi diskutuar të gjithë këtë me amerikanët, gjithmonë kam menduar që mund të mos pajtohesh me amerikanët, dhe shpesh nuk jam pajtuar, por jo të i mashtrosh sepse pastaj hidhërohen, duhet të jesh besnik edhe kur nuk pajtohesh. Kemi folur për Rugovën me Clintonin, ka pasur dyshime të mëdha, ai ka menduar që si të lirohet do të i thotë NATO-s, “Ndaloni!” Si pacifist, dhe kjo do të krijonte probleme. Në vend të kësaj Rugova...

Ne e siguroam lirinë e tij, e bindëm Miloševićin, [kishte] diskutime të gjata, dhe këtu Dini¹ kishte një rol kyç, Dini kishte marrëdhënie të mira me ta. Paradoksalisht unë, si një ish-komunist duhej të isha shok më i mirë me ta, por isha shumë më pak shok se Dini nga kjo perspektivë. Sidoqoftë, përfundimisht u bindën që edhe për qëllimin e një menaxhmenti më pak ekstremist do të ishte e dobishme të mirrej... Rugova u lirua, e dërguam në Itali, ne e pritëm në Itali dhe sapo erdhi në Itali ne patjetër që biseduam, ai e mbajti një konferencë për shtyp në të cilën e falenderoi NATO-n sepse po e mbronte popullin e tij. Dhe më kujtohet që Clintoni më telefonoi mua në celular, dhe më tha, “*Grazie, grazie, bravo*, shumë mirë, operacion shumë i mirë”. (qeshë) Fillimisht, ai ka qenë *szzzzz* [onomatopoeic] ata ishin në mëdyshje, pastaj situata u zhvillua shumë pozitivisht. Kthimi i Rugovës ishte triumf, fitorja e tij elektorale ishte një lumë votash, pastaj fatkeqësisht Rugova vdiq shumë herët nga kanceri, pra, nuk mundi ta ushtroj rolin e tij gjatë, por ai mbetet një figurë e jashtëzakonshme, ai është ende një simbol shumë i rëndësishëm. Herën e fundit që isha në Prishtinë shkova të vizitoj familjen e tij, të gjithë janë rritur, fëmijët, atyre iu kujtua kur kreu i Shërbimeve Sekrete iu kishte blerë akullore (qeshë).

Italia kishte një rol të rëndësishëm, një rol politik, një vend që mori pjesë në konflikt por punoi për një zgjidhje politike, një zgjidhje që serbët nuk do ta përjetonin si poshtëruese që ata të mundnin... dhe në fakt gjërat shkuan ashtu, ka pasur një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, të OKB-së, ishte dokumenti i Ahtisarit, kishte edhe një ndërhyrje ushtarake që i përfshinte edhe rusët, dhe Italia kishte një rol kyç shumë të rëndësishëm, nuk kishte ndodhur kurrë me parë, Italia ishte pjesë e komandës të rotacionit, morri përgjegjësinë për një pjesë të Kosovës dhe mbajti komandën e një pjese të kontigjentit të forcave të KFOR-it që përfshinin edhe ushtarakët e vendeve tjera, spanjollë, turk, portugez, ishte një pozicion i rëndësishëm që Italia nuk e kishte pasur kurrë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ishte një zgjidhje e vështirë, por nga këndvështrimi i rolit të vendit tonë ishte një zgjedhje shumë pozitive. Do të doja të shtoja që e gjithë kjo na ka lejuar që ta menaxhojmë situatën e refugjatëve në një mënyrë absolutisht shembullore. Nëse mendojmë për mjerimin që përfaqësonte kjo për Evropën nga refugjatët sirian, është një dimension tjetër, ishin 300 mijë refugjatë...

Anna Di Lellio: Shumë më shumë, 800 mijë.

¹ Lamberto Dini (1931), ekonomist dhe politikan italian, i pari i partisë së djathtë e themeluar nga Berlusconi, Shtëpia e Lirive dhe më vonë formimi i formacioni centrist The Olive Tree, ishte kryeministër i Italisë prej vitit 1995 deri më 1996. Në vitin 1999, gjatë kohës së intervenimit të NATO-s, ai ishte ministër i punëve të jashtme.

Massimo D'Alema: Ata të cilët i kemi menaxhuar ne ishin 300 mijë dhe brenda disa javëve, që mund të kishitë një impakt të mjerueshëm, pa menaxhim mund të kishim pasur barka në Adriatik, Shqipëria nuk mund të mbantë atë presion.... Askush nuk ka vërejtur asgjë, nuk kishte ndikim në opinionin italian. Pra, i kemi mirëpritur në Shqipëri me vullnetarë të tjerë dhe të gjithë atë njerëz që u angazhuan. Një gjë tjetër, nuk kishim takime në Bruksel, u bënë në telefon, me Austrinë, Gjermaninë... Në Itali, ne organizuam një fshat Kosovar në Sicili, e kemi marrur me aeroplana, anije, nuk kanë ardhur me barkë, askush nuk është mbytur. Kjo tregon që gjendjet kritike mund të menaxhohen, nëse ka pak solidaritet mund të menaxhohen, nuk është nevoja të mbingarkohemi. Kjo ishte e mundur sepse ne ishim aty, në komandën ushtarake.

Anna Di Lellio: Mund ta konfirmoj këtë, më kujtohet kur në Kukës, e di, kur menaxhmenti i një kampi shumë të madh të refugjatëve kaloi nga italianët te amerikanët kishte protesta të mëdha sepse cilësia e trajtimit të refugjatëve ra dukshëm, nga ushqimi deri te marrëdhëniet njerëzore, më kujtohet kur kaluan nga makaronat në hamburgera dhe çipsa, nuk ishte shumë... Ky kamp i Kukësit, ku kam punuar në vitin 1999, besoj që e ke vizituar njëherë... Cilat ishin përshtypjet tua?

Massimo D'Alema: Po, kam shkuar aty pak para se të fillonin operacinet ushtarake, isha aty në... gjatë Pashkëve, i kam kalur Pashkët aty.

Anna Di Lellio: Pra, në prill.

Massimo D'Alema: Po.

Anna di Lellio: Prill? Lufta ka filluar më 24 mars.

Massimo D'Alema: Mars? Nuk e di kur ishin pashkët, sidoqoftë kam shkuar atje gjatë pashkëve. Më kujtohet ishte mjaft mbresëlënëse. Ishte mbresëlënëse të shohësh këtë Shqipëri së prapthi, ku një lumë njerëzisht po arrinin, po iknin, por sidoqoftë ata kishin VW Golf, e kishe përshtypjen që po ikin nga një vend që ishte më i pasur... dhe pastaj sigurisht, ata njerëz, çfarë kishin përjetuar! Kam parë skena... ishte e qartë, të moshuar, të plagosur në këmbë me bajoneta, ishte e qartë aty, përdërisa njerëzit po iknin, të ndjekur nga një forcë ushtarake, ideja e mbrojtjes humanitare u shfaq me gjithë ato prova.

Ishte gjithashtu mirë ta shohësh këtë prani italiane, këta vullnetarë, çfarë përfaqëson anën më të mirë të vendit tonë. Jo, jo. Ishte një përvojë shumë e fortë njerëzore dhe konfirmim që duhej të bëhet diçka. Ndërhyrja ishte e duhur, ishte e duhur sepse ne duhej të reagonim kundër diçkaje që ishte e papranueshme nga pikënamja njerëzore, civilizimit, një brutalitet i papranueshëm.

Anna Di Lellio: Folët për debatin për përdorimin e trupave të armatosura tokësorë. A keni pasur ndonjë dyshim ma vonë, duke e ditur çfarë ka ndodhur, sepse gjatë luftës nuk kishte mbrojtje, kishte kontrollë totale të aparatit serb të sigurisë. Krime mizore kanë ndodhur në terren, dhunime, vrasje, shkatërrime të shtëpive, shkatërrime, nuk ishte askush që mund... qartazi UÇK nuk mund ta mbronte popullatën nga kjo ushtri e madhe. A e keni menduar ndonjëherë këtë?

Massimo D'Alema: Po, por le të jemi të qartë. Nuk është se një fushatë ushtarake do të mund të i mbronte njerëzit menjëherë. Një konflikt i tillë do të kishte zgjatur për një kohë, do të kishte një kohëzgjatje. Përtej forcave jopropocionale, serbët kishin përparësi të mëdha në terren, nuk do të kishte qenë e lehtë, dhe sipas mendimit tim, do të kushtonte shumë me jetë njerëzish. Nuk e di nëse kjo do të i kishte rritur apo zvogëluar dëmet... është e vështirë të vlerësohet kjo, shumë e vështirë të vlerësohet kjo, dhe sidoqoftë pasojat edhe nga këndvështrimi politik edhe juridik, thyerja, sepse, shkurt... Edhe bombardimi ishte thyerje, ndërhyrja pa autorizimin e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara do të kishte paraqitur një shkelje të ligjshmërisë ndërkombëtare që do të ishte riparuar me vështirësi.

Përderisa pas të gjithash, në fund, ne gjithashtu u desh të rindërtojmë. Përfundimisht, gjithashtu sepse ne nuk intervenuam, mund ta gjenim një zgjidhje, rezolutën e Këshillit të Sigurimit që shpalli një kornizë të legjimitetit ndërkombëtar. Përndryshe, më pas do të kishte qenë shumë e vështirë të menaxhohet periudha e pas luftës në aspektin politik. Pra kjo, duhet të kuptojmë se sa delikate ishte ajo që po ndodhte. Përfundimisht, gjithashtu sepse NATO mbeti me disa limite, ishte e mundur të thuhet, “Shumë mirë, le të krijojmë një forcë shumëkombëshe, të kemi një zgjidhje për Këshillin e Sigurimit, në atë pikë ushtria jonë hynë në Kosovë me një kornizë ligjshmërie ndërkombëtare plotësisht të riparuar”. Mendoj se *post hoc* ishte shumë më mençur të veprojmë ashtu si kemi vepruar.

Kjo nënkupton kostot, pa dyshim, shumë humbje civile, pjesa më e madhe e humbjeve kanë qenë civile edhe për serbët, sepse kishte dëme kolaterale të bombardimeve, sado që kishin shënjestra të sakta. E gjithë kjo është sigurisht e dhimbshme. Sipas mendimit tim, jo ndërhyrja ose ndonjë ndërhyrje e llojit tjetër do të kishte nënkuptuar kosto njejtë të dhimbshme. Si shpërblim, ajo çfarë bëme më në fund na shpiu në një zgjidhje, një zgjidhje të qëndrueshme, sinqerisht, në një moment OKB është dashur të kthehet, ne nuk mund të kishim menduar që ata mund të kishin dalur, kjo do të thoshte dëmtime të mëdha sistematike, dhe fakti që ushtria e NATO-s nuk ka shkelur në Kosovë ishte një ndër kushtet që OKB-ja të kthehet. Kishte shumë aspekte që të merren parasyshë, duke i përfshirë ato politike, dhe aspektet juridike që mund të i harronim.

Anna Di Lellio: Do të doja ta mbyllim me dy pyetje, një të përgjithshme dhe një pak më specifike, nga çfarë keni thënë: A jep ndërhyrja në Kosovë ndonjë mësim? Po menoj për çfarë ka ndodhur në Libi në 2011, gjithashtu ishte një ndërhyrje për të mbrojtur civilët, e autorizur nga Këshilli i Sigurimit, që shkoi në një drejtim të caktuar. Nëse Kosova mund të konsiderohet precedent për diçka, si e shihni ju?

Massimo D'Alema: E përsëris, në Libi, dallimi rrënjësor sipas mendimit tim është: në Kosovë kishte një ndërhyrje ushtarake por kishte gjithashtu edhe një menaxhim politik të mençur të të gjithë operacionit. Në fund kishte një ide se si të rikthehet rendi, një mendim për klasat qeverisëse. Operacioni Rugova ishte një aspekt i rëndësishëm i kësaj. Në Libi përderisa ndërhyrja zhvillohej nuk kishte fare mendim politik, ndërhyrja i kontribuoi ndarjes. Po, i ndaloi torturat e Gheddafit në periferi të Bënghezit, shumë mirë, por pasi që u tha kjo, nuk ishte askush që kishte ide se si të rregullohet gjendja. Duhet të them se në vend të kësaj ne kishim në mendje se në një mënyrë humbja në Kosovë mund të hapte një proces ndryshimi në Serbi dhe ajo ndodhi. Sepse humbja në Kosovë gjithashtu kishte...

E kam gjetur vetën, pas disa vitesh, kohëve të fundit, si ministër i punëve të jashtme, duke e menaxhuar kalimin, në fund të mandatit, kalimin te Këshilli i Sigurimit, kur dokumenti i Ahtisarit

propozoi pavarësinë e Kosovës. Nuk kishte marrëveshje, unë kryesova Këshillin e Sigurimit, sepse fati deshti që ajo dosje të arrijë në Këshillin e Sigurimit gjatë muajit që Italia ishte president, Italia ishte anëtare e Këshillit të Sigurimit dhe ishte president, ishte radha e saj. Unë isha Ministër i Punëve të Jashtme, dhe thashë, kishim një ambasador shumë t'mirë, por unë thashë, "Po vij", duke e pasur parasyshtë rëndësinë... Unë e kam drejtuar Këshillin e Sigurimit, me Koštunicën,² kosovarët, me të gjithë protagonistët që ishin aty, unë e avancova sygjërimin, morra parasyshtë që nuk kishte konsensus, rusët... ishte një takim i rëndësishëm, e gjeta vetën duke u takuar prapë më Kosovën pas disa viteve, ishte një gjendje tjetër por jo me pak e rëndësishme, le të themi.

Por gjatë mandatit tim si Ministër i Punëve të Jashtme, shkova në Beograd për të inaguruar Institutin e Kulturës në Beograd. Ishte një kalim delikat, sepse si njihem në Kosovë, edhe në Beograd e dijnë se jam një ndër ata që shkuan në luftë... Ishte një event me shumë njerëz, kam takur të rinjë, të rinjë, që më thanë, "Po, keni qenë në luftë me ne por në fund të ditës na keni liruar edhe neve, na keni liruar edhe neve". Në një pjesë të opinionit publik në Serbi, po, nacionalizmi është ende i fortë, por është një pjesë e opinionit publik në Serbi që e ka parë procesin si fillimin e demokratizimit, çlirimit të Serbisë gjithashtu.

Lufta në Kosovë e kishte edhe këtë domethënie... por, kishte një ide se çfarë duhej të ndodhte më pas, idea nuk u realizua, por një objektiv u arrit, u ndalën së vrari njëri-tjetrin, kanë qenë duke e vrarë njëri-tjetrin për dhjetë vjet. Nuk mund të harrojmë që lufta në Kosovë ka qenë episodi përfundimtar i një zinxhiri konfliktesh, pra, besoj që ka një dallim: një gjë është kur lufta bëhet, siç ka thënë vonë Klausevitz, "Lufta është vazhdimi i politikës me mjete tjera", por sidoqoftë është brenda një procesi politik, por është ndryshe kur mendon se mund të zëvendësosh politikën me luftë. Dhe pastaj bën telashe, si në Irak ose Libi, sepse lufta... ndonjëherë përdorimi i dhunës është i pashmangshëm, por politika duhet të jetë parësore. Kur, e përsëris nuk ke ide politike, kur themi, "Ne nuk e dijme çfarë po ndodhë, nuk e dijme çfarë të bëjmë, të i hudhim dy bomba", gjërat nuk funksionojnë mirë dhe e kemi parë në fakt. Pra, nga ky këndvështrim unë jam kundër... Nuk kam qenë kurrë pacifist, por gjithmonë kam menduar që politika duhet të vijë e para. Kur politika e humbë parësinë, si në luftë dhe në ekonomi, gjërat shkojnë keq.

Anna Di Lellio: Për të përfunduar, çfarë mendon për zhvillimin e Kosovës tani, je ende i interesuar për Kosovën. Nuk mund ta lëshë kurrë Kosovën...

Massimo D'Alema: Kjo ka qenë zgjedhje... Fondacioni i të cilit jam president ka një bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës dhe kemi kontakt. Ai ka fonde për bashkëpunim ndërkombëtar.

Anna Di Lellio: Si e sheh punën tënde këtu, perspektivën?

Massimo D'Alema: Shumë vite kanë kaluar, dhe mendoj që perspektiva për Ballkanin është të përfundojë procesin e paqës dhe të fillojë një bashkëpunim më të madh dhe ka progres në këtë

² Vojislav Koštunica (1944), intelektual serb dhe themelues i Partisë Demokratike në vitin 1989, dhe Partisë Demokratikë të Serbisë në vitin 1992. Ishte president i Jugosllavisë nga viti 2000 deri në vitin 2003 dhe kryeministër i Serbisë nga viti 2004 deri në vitin 2007 dhe nga viti 2007 deri në vitin 2008.

drejtim. Kam marrur pjesë me Joschka Fischer³ dhe Védrine⁴ si dëshmitarë në një takim të shtetarëve në Tiranë. Ishte shumë mirë. Bashkëpunim politik dhe ekonomik, paqja si përfundim është perspektiva për të cilën duhet punuar dhe përgjatë kësaj rruge është e qartë që çështja e madhe e pazgjidhur është njohja reciproke në mes të Serbisë dhe Kosovës dhe rrjedhimisht, fillimi i bashkëpunimit reciprok. Negocimi është i hapur, duhet të them se Bashkimi Evropian ka punuar këtu shumë pozitivisht me qëllime pozitive, gjithashtu sepse ky është kushti që e favorizon një proces të integritimit. Mbetem i bindur që Bashkimi Evropian duhet të jetë i hapur për integrimin e Ballkanit Perëndimor edhe pse e di që ka kundërshtime, ndoshta nuk është realiste të mendosh që kjo mund të ndodhë në afat të shkurtër.

Negocimi është i hapur, është një negociim i vështirë, sipas mendimit tim ana kosovare, ndërsa ana serbe duket më shumë... Jo që nuk ka rezistencë të fortë ky negociim, një rezistencë parimore, ata që thonë, “Nuk duhet ta njohim kurrë Kosovën”, sepse Kosova është pjesë e Serbisë është e shkruar në Kushtetutë, duhet ta ndrojnë kushtetutën; ka kundërshtime... për shembull, kisha ortodokse është krejtësisht kundër, ndërkombëtarisht rusët janë shumë të kujdesshëm, por shumica e udhëheqjes serbe janë, duket sa janë të orientuar për një marrëveshje.

Në anën e kosovarëve sipas mendimit tim, nuk ka qartësi se çfarë kërkojnë ose çfarë janë të gatshëm të ngociojnë, është një ndarje, kjo temë ka qenë objekt i një mospajtimi mes të presidentit të rebulikës i cili është mandatuar të kryej këtë negociim dhe te tjerë, kryeministrit, i cili gjithmonë e ka kundërshtuar atë, në veçanti e ka kundërshtuar shkëmbimin territorial, rishikim e kufijëve që nga fillimi është qëllimi i serbëve. Sipas mendimit tim, nuk mund të zhvillohen negociata kaq delikate pa një shkallë bashkimi kombëtar - gjithmonë i kam këshilluar miqët e mi kosovar, “Para se të bisedoni me serbët ju duhet të bini dakord me njëri-tjetrin” (buzëqeshë) - dhe pa një ide të qartë të asaj që ata duan të arrijnë dhe atë çfarë janë të përgaditur të pranojnë... Negocimi përbëhet gjithmonë nga këto aspekte të ndryshme. Nuk e shoh ndryshimin e kufijëve veçanërisht të favorshëm sepse jemi në një pjesë të botës ku kufinjët janë aq delikat sa që kjo rrezikon të ndezë... Përveç nëse ky operacion ndahet, pranohet, kufizohet dhe garantohet ndërkombëtarisht. Ja pra!

Ne, ne si fundacion kulturor, gjithashtu paraqitëm një propozim, nuk po them jo një propozim alternativ por një propozim interesant sipas mendimit tim krijimi i *free zone* [zonë e lirë], një zonë zhvillimi ndërkufitar, sipas përvojave të tjera në pjesë të tjera të botës, ku ka pasur konflikte, e të tjera. Pra, në veri të Kosovës, le të themi enklava serbe, me shumicë serbe, dhe pjesa jugore e Serbisë, një zonë e integruar e zhvillimit të serbëve dhe kosovarëve, ku njerëzit mund të punojnë bashkë, me qarkullim të lirë të njerëzve, për të zbutur temën e kufijve dhe për të kërkuar diçka më shumë se paqe, por një bashkëpunim të vërtetë.

Sipas mendimit tim kjo mund të jetë një iniciativë kreative që mund... e kemi diskutuar, shkurt, duket se... askush nuk e ka hedhur poshtë, as... kam folur për këtë me Vučić⁵ kam shkuar ta shoh, kemi drekuar së bashku, e kemi pasur një diskutim të gjatë, personal, të lirë, një diskutim të gjatë...

³ Joseph Martin (Joschka) Fischer (1948), politikan gjerman i të Gjëlbertve i cili ishte zëvendëskryetar dhe ministër i jashtëm nga viti 1998 deri në vitin 2005.

⁴ Hubert Védrine (1947), politikan socialist francez, ishte ministër i jashtëm nga viti 1997 deri në vitin 2002.

⁵ Aleksandar Vučić (1970), politikan serb i cili ishte ministër i informacionit të Milošević nga viti 1998 deri në vitin 200; një nga themeluesit dhe udhëheqësit i Partisë Prgressive Serbe (PPS), një parti konservatore populliste; kryeministër i Serbisë nga viti 2014 deri në vitin 2017; president i Serbisë nga viti 2017.

Anna Di Lellio: Më fal, por cilët do të jenë kufinjët e kësaj zone? Veriut të Kosovës dhe Serbisë? Sepse tani më ka qarkullim të lirë aty, nuk ka kufi aty në mes të veriut të Kosovës dhe Serbisë. Kufiri është Mitrovica...

Massimo D'Alema: Kufiri?

Anna Di Lellio: Kufiri i vërtetë qyteti i Mitrovicës. A e përfshinë kjo pjesën jugore të Mitrovicës?

Massimo D'Alema: Po, përfshinë një pjesë të Kosovës dhe një pjesë të Serbisë. Po, natyrisht ne i formuam disa parime të përgjithëshme, por sapo të pranohet idea do të diskutohen kufinjët. Do të jetë një zonë zhvillimi, nuk do të shtjelloj kufinjët në mes të vendeve, por do të thonim, në këtë zonë... Një përvojë e tillë është bërë pas Luftës së Dytë Botërore nëpër Zvicër, Francë, Gjermani, një zonë e madhe e integruar e zhvillimit, para lindjes së Bashkimit Evropian, ku vendimi ishte se nuk do të kishte kufinjë por do të kishte autoritet, ka rezultate. Kishte rezultatin e një zhvillimi të jashtëzakonshëm ekonomik, ka përvoja të tilla... Natyrisht kjo duhet të ketë mbështetje nga Evropa, kam folur me Mogherinin, kemi pajtim, Bashkimi Evropian do të investonte në infrastrukturë, e të tjera, do të kishte investime, kemi folur në Itali edhe me Confindustria⁶ e të tjera, pra një operim i mbështetur nga disa qeveri, nga Bashkimi Evropian, për të krijuar një zonë të zhvillimit ekonomik intenziv, gjithashtu me nxitje e të tjera, për ndërmarrësit për të investuar këtu, të menaxhuar ng autoritete të përziera, serb dhe kosovarë, pa diskutuar kufinjët kombëtarë. Një veprim që nuk dëshiron të ndërhyj me negociimet e kufijëve, por që disi dëshiron ta zbutë atë, por më së shumti të krijojë një rast për bashkëpunim dhe të vazhdojë nga lufta në bashkëpunim, jo një armëpushim me armë te këmbët tona. Është një operim i vështirë por interesant, nuk e di, kam frikë se kontrasti, presionet ndërkombëtare, nuk e di...

Nuk e kam kuptuar se çfarë amerikanët dëshirojnë, amerikanët fillimisht thanë, pastaj e mohuan, fillimisht thanë që nuk e kundërshtojnë shkëmbimin territorial, pastaj e mohuan. Qëndrimi i amerikanëve nuk po ndihmon shumë, unë ndjej që sigurisht, Evropa është shumë e interesuar për një zgjidhje, gjithashtu se kjo do të thotë, si të them, të hapë perspektivë për bashkëpunim me të gjithë vendet në rajon, por as amerikanët as rusët nuk duken të interesuar, në të kundërtën ata duket se duan të mbajnë tensionet që po luhen në fushën e shahut të marrëdhënjes së vështirë amerikano-ruse. Putini shkon në Beograd, por amerikanët duket se inkurajojnë pozicione që, themi janë më të ashpra në Kosovë, më shumë se ata që janë më të hapura për dialog.

Personalisht, mendoj, le të jemi të qartë, që kjo marrëveshje është jashtëzakonisht e nevojshme, do të thosha më shumë për Kosovën se Serbinë. Në fund te fundit Serbia është pjesë e Kombeve të Bashkuara, ka një rritje të fortë, ka investime të forta ndërkombëtare, po, është e vërtetë që derisa të bëjnë paqe me Kosovën, do të kenë telashe me Bashkimin Evropian, por tani Bashkimi Evropian nuk është në gjendje të ofrojë perspektivë të madhe. Në vend të kësaj, Kosova nëse vazhdon të jetë në këtë situata të gjysmë-njohjes, paguan një çmim më të lartë. Pra, nëse mund të u jepja një këshillë miqëve të mi kosovarë, "Mundohuni të gjeni një marrëveshje, mundohuni të shtyni për një marrëveshje, mos e humbni këtë dritare të mundësisë", kjo është, nëse mbërrijmë në zgjedhjet Evropiane, duhet të fillojmë nga zero. Tani kjo histori menaxhohet nga komisioni aktual, nga Përfaqësuesja e Lartë aktuale, Mogherini, që është shumë e përfshirë, sipas mendimit tim shumë mirë, me një drejtim të mirë.

⁶ Konfederata e përgjithshme e Industrisë Italiane, Dhoma Kombëtare e Tregtisë të Italisë.

Nëse nuk gjejmë një mënyrë tani, rreziku është që çdo gjë shtyhet, dhe kjo nuk është pozitive. Nuk është pozitive sepse jetojmë në një moment tensionesh të mëdha ndërkombëtare dhe zakonisht kur ka tensione ndërkombëtare, këto pasqyrohen në Ballkan, është fakt historik, i takon historisë së dy-tri shekujve të fundit. Nëse, le të themi, në Ballkan, elita kthehet prapa për t'u vendosur në shërbimin e kësaj apo asaj fuqie të huaj, sipas mendimit tim Ballkani do të paguaj çmim shumë të lartë. Nëse e kuptojnë që perspektiva e vetme për ta është të gjejnë një marrëveshje për zhvillimin këtij rajoni, mendoj që ka mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim. Në tërësi, është një elitë që përfaqëson një gjeneratë të re që mundet, mendoj... Nëse mendoj për Edi Ramën në Tiranë, vetë Vučić, ata mund të jenë protagonistë të një kthese historike, nëse kanë guximin ta bëjnë. Natyrisht, kush nuk ka guxim nuk mund të ia jap vetës, siç ka thënë një shkrimtarë i madh. Çfarë mund të bëjmë është të mundohemi të ndihmojmë. Gjithmonë kamë thënë, meqenëse kam bërë luftë, do të dëshiroja të kontribuoja për paqe.

Anna Di Lellio: Dhe me këtë, nëse nuk keni asgjë për të shtuar, mund ta mbyllim.

Massimo D'Alema: Do të kishte shumë gjëra, po them mjaftueshëm.

Anna Di Lellio: Në rregull, faleminderit.